




Për komunitete rezistente
ndaj radikalizmit dhe
ekstremizmit të dhunshëm!

- Udhëzues për profesionistët në fushën e arsimit -





Për komunitete rezistente
ndaj radikalizmit dhe
ekstremizmit të dhunshëm!

- Udhezues për profesionistët në fushën e arsimit-

PËR KOMUNITETE REZISTENTE NDAJ RADIKALIZMIT DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM!

- Udhezues për profesionistët në fushën e arsimit -

Botues:

Qendra për Edukim Qytetarë (QEQ)

Redaktorët:

Petar Gjukanoviq
Dalliborka Ulareviq

Autorja kryesore:

Jarmila Bujak Stanko

Koautorët:

Izabella Kisiq
Srgjan Barishiq
Petar Gjukanoviq



Centar za građansko obrazovanje
Centre for Civic Education

Publikimi është pjesë e projektit "Rrjeti i sigurtë" të cilin e realizon Qendra për Edukim Qytetarë (QEQ) përmes Fondit për Qytetari Aktive (FQA) në kuadër të programit Për zë më të fuqishëm të shoqërisë civile! të cilin finansijarisht e përkrah Ambasada e SHBA-ve në Podgoricë.



fond za
aktivno građanstvo

Qëndrimet e paraqitura në këtë publikim u përkasin autorëve dhe janë përgjegjësi e tyre dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e FQA dhe Ambasadës së SHBA-së.

Përmbajtja

I.	Hyrje	6
II.	Njohja dhe kuptimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm	7
	• Termat kyç	7
	• Identifikimi i personave në rrezik nga radikalizimi	8
	• Faktorët e radikalizimit	10
	• Radikalizimi si proces	13
	• Shenjat e hershme të radikalizimit dhe ekstremizmit	14
	• Udhëzime praktike për veprim në situata konkrete	17
	• Organizimi i diskutimeve për ekstremizëm dhe radikalizëm në shkolla	19
III.	Korniza ligjore ndërkombëtare kundra ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit	24
	• Definimi i terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në dokumentet ndërkombëtare	24
	• Rregullat në Evropë	26
	• Rrespektimi i të drejtave të njeriut në luftë kundra terrorizmit	27
IV.	Termat e rëndësishëm	28
V.	Lidhje të dobishme	30

U R K I

Udhezuesi për profesionistët në fushën e arsimit ***Për komunitete rezistente ndaj radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm!*** është krijuar nga nevoja që të forcohen kapacitetet e sistemit arsimorë në drejtim të parandalimit efikas të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm janë sfida serioze me të cilat ballafaqohen shoqëritë moderne, madje edhe Mali i Zi. Arsimit karolin kyç në parandalimin e këtyre fenomenëve përmes ngritjes së nivelit të dijes dhe informimit të rinjëve, por edhe përmes zhvillimit të vlerave, qëndrimeve dhe shkathtësive që do ti bëjnë të rezistueshem ndaj tërheqjes së grupeve radikale dhe ekstremiste dhe propagandës.

Udhezuesi do tu mundësojë profesionistëve në fushën e arsimit që të kuptojnë radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, të njohin faktorët e rrezikut dhe shenjat e para. Gjithashtu, udhezuesi ofron udhëzime praktike për qasje në mësim dhe punim të temes, veprimin në raste konkrete në klasë dhe komunikimin me të rinjtë. Në fund, udhezuesi duhet të ndihmojë në formimin e klimes e cila është inkluzive dhe inkurajuese për dialog, diskutim të

hapur dhe mendim kritik në punën e përditshme me të rinjtë dhe në përgjithësi në mjedisin e shkollës, dhe në bashkëpunim me prindërit dhe bashkësinë lokale.

Arsimi nuk është i plotëfuqishëm. Megjithatë, informimi më i mirë mund të ndihmojë në delegjitimimin e ideologjive radikale. Kjo përfshinë zhvillimin e mendimit kritik, kuptimin e procesëve shoqërore dhe forcimin e aktivizmit tek të rinjtë përmes bisedës në lidhje me temat kontroverze dhe temat në atmosferë nxitëse. Prandaj, roli i stafit arsimorë dhe të gjithë profesionistëve tjerë të cilët punojnë në shkollë është posaçërisht e rëndësishëm dhe besojmë se ky udhezues do të jetë mjet plotësues cilësor i cili do t'u mundësojë që të pergjigjen në detyren e tyre në parandalimin e zhvillimit të radikalizimit në mesin e të rinjve.

Udhezuesi është krijuar në kuader të projektit *Rjeti i sigurtë* qellimi i të cilit është kontributi në forcimin e rolit të sistemit arsimorë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, por edhe në promovimin e kulturës së dialogut shoqëror dhe bashkëpunimit, vlerave dhe të drejtave njerëzore si mehanizem parandalues kundra terorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Njohja dhe kuptimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm

Termet kyç

Në këtë fushë nuk ka shumë marrëveshje për domethënijen e termave kyç. Shumë terma nënkuptojnë gjëra të ndryshme në burime të ndryshme, përdorën si sinonime pa definicione dhe percaktime të qarta. Aktorët kryesorë ndërkombëtarë poashtu nuk kanë definicione zyrtare të termave kyç që përdoren vazhdimisht. Për këto arsye ofrojmë fjalorin me listen e burimeve për njohje të mëtejshme dhe më të thellë por edhe për studimin e dilemave aktuale.

- **Ekstremizmi** – ideologjitë të cilat janë në kundërshtim me vlerat e përgjithshme dhe principet e demokracisë, sundimin e ligjit, të drejtat universale të njeriut, liritë personale, respektimin dhe tolerancën e ndërsjelltë të besimeve dhe bindjeve të ndryshme.
- **Ekstremizmi i dhunshëm** – ideologjitë që janë në kundërshtim me vlerat dhe parimet themelore të përgjithshme dhe avokojnë përdorimin e dhunës për të arritur qëllimet që janë kryesisht me natyrë ideologjike, sociale, raciale, fetare dhe/ose politike.
- **Radikalizimi** – proces me të cilin një individ, grup ose masë e njerëzve ekspozohen hapas mesazheve ideologjike ekstremiste dhe sistemit të besimit dhe/ose kalojnë përmes transformimit të bindjeve të tyre nga relativisht të qeta dhe të pranuar në përgjithësi deri në miratimin e pikëpamjeve, idealeve dhe aspiratave ekstremiste.
- **Radikalizuesi** – personi i cili nxit të tjerët që të zhvillojnë dhe fitojnë bindje dhe qëndrime ekstremiste.
- **Materiali radikalizues** - literatura ose video inçizimi të cilin e përdor radikalizuesi për nxitjen ose inkurajimin e individëve që të marrin ideologji ekstremiste.
- **Radikalizimi terrorist** – procesi me të cilin individ, grupi apo masa e njerëzve ekspozohen hapas mesazheve ideologjike terroriste dhe sistemit të besimit apo kalojnë përmes transformimit të bindjeve të veta nga relativisht të qeta të pranuar deri tek formimi i pamjeve terroriste, idealeve dhe aspiratave, të cilat mund të çojnë deri tek aktet terroriste.
- **Radikalizimi terrorist i pavarur dhe vetëinicies** – rastet kur personat radikalizohen kundër terrorizmit me një shkallë minimale të bashkëveprimit me radikalizuesit. Lidhet me shfaqjen e „terroristave vetiak“ ose „vetëiniciesit“, të cilët veprojnë në bazë të gjykimit të tyre, pa udhëzime nga jashtë, përkrahje ose përkatësisë së ndonjë organizatë terroriste.
- **Kontra-radikalizimi** – aktivitetet, politikat dhe programet e drejtuara tek grupet e njerëzve me qëllim parandalimi të radikalizimit duke zvogëluar ndjeshmërinë dhe duke rritur rezistencën. Paket programesh shoqërore, politike, juridike, arsimore dhe ekonomike, qëllimi i të cilit është ndryshimi i kushteve të cilat mund të nxisin individin në radikalizem. Ata janë posaçërisht të dizajnueme që të ndalojnë njerëzit e pakënaqur (eventualisht të radikalizuarit) që të nisin ose vazhdojnë

rrugën e radikalizimit.

- **De-radikalizimi** – programet të cilat janë të drejtuara kundra individit të cilët janë bërë radikal me qëllim që përsëri të integrohen në shoqëri ose që të largohen nga dhuna. Tentimi për të kthyer nga procesi i radikalizimit ata njerëz të cilët janë plotësisht ose pjesërisht të radikalizuar ose ndihmohen që të largohen nga grupet radikale dhe ekstreme, pavarësisht nëse ata do të ndryshojnë idetë e tyre apo jo.
- **Rezistenca në radikalizim** – aftësitë e individit, grupit dhe komunitetit që të reagojnë, ti hedhin poshtë apo të refuzojnë promovuesit e ekstremizmit dhe ideologjive të cilat ata i promovojnë.
- **Dobësia në radikalizem** - senzibiliteti ndaj radikalizimit, rritja e ndjeshmërisë dhe mungesa e mbrojtjes nga sulmet morale dhe ideologjike të radikalizuesit. Shumë faktor dhe karakteristika të cilat e përbëjnë individin, grupin, komunitetin ose shoqërinë posaçërisht të ndjeshme në radikalizem.
- **Terorizmi** – përdorimi i veprimeve të qellueshme dhe sistematike të dhunës, të menduara që të nxisin terror në publik ose të ndikojnë në qeveri si mjet për arritjen e qëllimeve politike, fetare ose ideologjike. Terorizmi është lloj i ekstremizmit të dhunshëm.
- **Propaganda terroriste** – perhajpja e pamjeve të caktuara ekstremiste të dhunshme e cila i percakton individet e qelluem që të arsyetojnë dhe pranojnë këto ide.

Identifikimi i personave në rrezik nga radikalizimi

Ekstremizmi i dhunshëm dhe ndikimet e radikalizmit në themel të tij janë ndër sfidat më të mëdha të kohës sonë. Duke vërejtur që radikalizimi dhe ekstremizmi terheqin shumë e më shumë vemendje në shoqërinë tonë, bëhet e qartë sa i rëndësishëm është identifikimi i individëve të cilët janë në rrezik të posaçëm nga radikalizimi.

Kjo është paraqitë si detyrë shumë sfiduese. Në njërin anë, ekstremizmi i dhunshëm nuk është i kufizuar në moshë, gjini, grup apo komunitet. Në anën tjetër, disa grupe sociale, janë veçanërisht të ndjeshme ndaj efekteve të radikalizuesve, të synuara posaçërisht përmes rekrutimit ekstremist dhe, rrjedhimisht, të zgjedhura posaçërisht për ndërhyrjet e mbrojtjes së radikalizimit të synuar.

Grupet sociale të cilat janë shpesh të përmendura dhe që janë të rrezikuara nga radikalizimi janë: femija dhe të rinjtë, ata të cilët kanë eksperiencë në ekstremizem të dhunshëm dhe konflikte, njerëzit me prejardhje dhe status të ulët socio-ekonomik, femrat dhe meshkujt në mënyra të ndryshme, familjet, të kthyerit në besim musliman, ata të cilët vuajnë diskriminimin dhe ngacmimet racore apo fetare.

Femijët dhe të rinjtë me prejardhje të ndryshme mund të jenë posaçërisht të ndjeshëm në radikalizem

sepse janë në moshë në të cilën luftojnë për identitet dhe vlera, kërkojnë përgjigje për besimin dhe perkatësinë dhe janë të etur për aventura. Të gjitha këto mund ti bëjnë të hapur për ndikime ekstremiste të cilat u premtojnë përgjigje, identitet, vlera të qarta dhe rrjetë shoqërore të fortë. Gjithashtu, përdorimi strategjik dhe i sofistikuar i internetit dhe mediave shoqërore për të synuar të rinjtë i bën ata më të ndjeshëm nga qytetarët tjerë, posaçërisht për arsye të kohës që të rinjtë dhe fëmijet kalojnë në internet dhe materialeve të cilat u ekspozohen në këto burime, pa kapacitet të mjaftueshëm që tu rezistojnë radikalizuesve dhe pa mbikqyrje të mjaftueshme. Fëmijet me prejardhje të ndryshme mund të radikalizohen, sepse kjo është koha më e vështirë dhe më kërkuese për çdo person, e faktoret e brendshëm dhe jashtëm mund të rrisin lëndueshmërinë e tyre.

Njerëzit të cilët jetojnë në zonat të cilat kanë **histori të ekstremizmit dhe konfliktit**, janë aktivisht në shenjester nga ana e grupeve ekstremiste dhe janë shumë të lëndueshëm në radikalizim dhe regrutim.

Ekstremistet e rekrutuar kryesisht janë (por jo gjithmonë) meshkujt. Ne anën tjetër, **femrat dhe familjet** janë gjithnjë e më shumë në shenjester të ekstremistëve regrutues¹. Disa në shenjester, në mënyrë eksplicite, kanë femrat për akte të dhunshme dhe kanë për qellim fshirjen e

balancimit gjinorë në përkrahjen e ekstremizmit². Në mënyrë të veçantë, faktet e fundit tregojnë se disa grupe të caktuara, siç janë femrat e reja muslimane, kanë qenë shenjester e radikalizimit, që ka prurë deri tek (tentimi) shkuarja në Lindjen e Mesme, që i vën në rrezik.

Ata të cilët janë të ndjeshëm në radikalizim janë **të konvertuarit në fenë muslimane**. Ata mund të kenë prejardhje nga shumë komunitete etnike të ndryshme, e jo vetëm nga komunitete tradicionale muslimane.

Identifikimi i personave konkret të cilët janë të rrezikuar nga këto grupe shoqërore mund të jetë jashtëzakonisht i ndjeshëm dhe sfidues. Nuk mundemi të theksojmë mjaftueshëm sa e rëndësishme është të sigurojmë nga demtimi i shtuar personat e rrezikuar për arsye të thjeshtëzimit të tepërt në zbatimin e modelit të lëndueshmërisë në radikalizim. Informacionet e cekura më lartë në asnjë mënyrë nuk do guxohet të përdoren për ndarje ose etiketim të individit apo grupit të „radikalizuar“ ose „të gatshëm për radikalizim“. Keqëpërdorimi i këtij llojit, është vertetur si kontraproduktiv. Vlerësimet e tepërta të bazuara në treguesit demografik dhe treguesit e varfërisë vazhdimisht rrisin viktimizimin, marginalizimin dhe diskriminimin e personave të cilët veç janë në rrezik, nuk arrisin të identifikojnë lëndueshmërinë reale, dhe në disa raste, madje rrisin kredibilitetin dhe aftësitë ekstremiste

¹ <https://www.corby.gov.uk/sites/default/files/documents/files/Safeguarding%20Policy%202016.pdf>

² <https://www.publications.parliament.uk/pa/cm201012/cmselect/cmhaff/1446/144604.htm#note25>

të eksploatojnë personat dhe grupet e lëndueshme, kanë ndikim tek ata dhe i regrutojnë.

Perdorimin e kujdesshëm të informacioneve për vulnerabilitet e përcaktojnë edhe kufizimet metodologjike në hulumtimin e këtij fenomeni ende të panjohur. Të dhëna për radikalizem ende nuk ka boll, madje as të dhënat ekzistuese nuk kënaqin kriteret rigorozë të kualitetit shkencor. Për shkak të natyrës së këtij fenomeni të dhënat edhe nuk janë mjaft në dispozicion (mosinteresimi i personave radikalizues, të dhënat sekrete, çështja e sigurisë, etj), çka do të thotë se hulumtimet e verteta metodologjike të cilat janë të nevojshme që të rezultojnë me modelin e besueshëm i cili mundëson intervenime efektive, ende mungojnë. Për më tepër, radikalizimi si një fenomen shoqëror po ndryshon dhe lëviz vazhdimisht, madje edhe më shumë për shkak të përshtatjes me qëllim të rekrutuesve ekstremistë në ndërhyrjet shtetërore dhe komunitare. Ashtu që edhe trendet e vërejtura dhe gjendja nuk duhet të mbesin të njëjtë edhe në periudhen e ardhshme, ashtu që hulumtimet e reja duhet të përcjellen në kontinuitet.

Paraqitja e rrezikut nga radikalizimi është jashtëzakonisht komplekse. Edhe pse disa arsye të lëndueshmërisë të shtuar janë zbuluar, ende qëndron se nuk ka profil tipik ekstremist apo rrugë drej radikalizimit. Ata të cilët janë të kyçur në ekstremizem vijnë nga mjedisë të ndryshme dhe kanë eksperiencë të ndryshme. Lista e grupeve sociale të identifikuar mund të shërbejë si ndihmë profesionistëve që të kuptojnë dhe identifikojnë faktorët të cilët mund të sygjerojnë që femija, personi i ri apo familja e tyre mund të jenë të lëndueshme për radikalizem janë të kyçur në

radikalizem. Lista nuk është e plotë dhe çdo karakteristikë apo asnjë karakteristikë mund të jetë e pranishme në raste të veçanta, e lëndueshmëria mund të manifestohet edhe në disa mënyra krejtësisht të ndryshme, pra këta indikator nuk mund të jenë informacioni i vetëm i cili është i nevojshëm për vlerësim të përshtatshëm të lëndueshmërisë. Këto të dhëna, gjithashtu, nuk do të thonë se të gjithë njerëzit e lëndueshëm, të cilët i perkasin këtyre grupeve automatikisht janë të rrezikuar nga radikalizimi dhe eksploatimi për nevojat ekstremiste. Është pranuar mendimi se lidhja komplekse ndërmjet aspektëve të ndryshme të identitetit të individit e përcakton lëndueshmërinë e tyre në ekstremizëm, megjithatë disa faktorë shoqërorë dhe demografik duhet të marrin në konsideratë me kujdes që të ndalojnë procesin e radikalizimit në çdo rast individual.

Radikalizimi është proces, e jo një ngjarje. Gjatë këtij procesi është e mundshme të intervenohet në çdo hapë dhe kështu të ndalohen personat vulnerabil që të bëhen pjesë e aktiviteteve që kanë lidhje me terrorizem. Ky është konteksti në të cilin informacionet për lëndueshmëri në radikalizim mund të perdoren në funksionin më të mire. Profesionistët dhe aktivistët në shoqëri mund të përdorin që të identifikojnë grupet dhe personat të cilët janë më të lëndueshëm dhe tu ofrojnë përkrahjen e nevojshme që ndjeshmëria e tyre të zbutet edhe para se të vijë deri tek ndikimi radikalizues apo në ndonjë fazë manipuluese nga ana e rekrutuesit.

Faktorët e radikalizimit

Radikalizimi është proces kompleks dhe dinamik deri në atë shkallë që mos të ekzistojë vetëm një rrugë deri tek radikalizimi ose personi tipik i cili ka prirje për radikalizim. Për këto arsye, profilimi i bazuar në karakteristikat individuale nacionale, gjeografike, fetare, statusit socio-ekonomik, gjinis, moshës apo ndonjë karakteristike tjetër individuale nuk është i mjaftueshem dhe i zbatueshem në praksë.

Në vend të kësaj, qasje më e zbatueshme dhe më e dobishme është analiza e faktorëve të cilët nxisin radikalizimin. Ekziston numër i madh i faktorëve dhe radikalizimi ndodhë në kushte të numërta komplekse socio-ekonomike, faktorëve institucional dhe psikologjik individual, dhe kushteve të brëndshme dhe të jashtme të cilat kombinohen në mënyrë unike në çdo rast individual.

Klasifikimi i faktorëve radikalizues të pranuar gjerësisht³ ndahen në: largues (push factors), tërheqes (pull factors) dhe kontekstual (contextual factors).

Faktorët largues (push) „shtyjnë“ individin në ekstremizem, krijojnë kushte për përhapjen dhe tërheqjen e ekstremizmit të dhunshëm. Ato janë kufizime të ndryshme, aksidente, humbje, padrejtësi të cilat radikalizuesit i shfrytëzojnë. Këta faktorë përfshijnë: margjinalizimin, pabarazinë, diskriminimin, përjashtimin social, persekutimin, kufizimin në arsim kualitativ, papunësinë, ndjenjen e padrejtësisë

për shkak të perjashtimit ekonomik dhe politik, mohimin e të drejtave dhe lirive qytetare, kercenimet egzistenciale, çështjen e identitetit, nevojen për lider të fuqishëm, dominimin kulturor, pasigurinë dhe padrejtësitë e tjera mjedisore, historike dhe socio-ekonomike ose vetem perceptimin e individit se padrejtësitë janë bërë. Ndër këta faktorë, ndjenja e mohimit dhe padrejtësia e perjetuar është proces kyç në procesin e radikalizimit dhe ekstremistët mbështeten në këtë.

Një grup faktorësh largues i zbuluar në hulumtim u referohet nevojave të brëndshme personale të individit të cilët nuk arrijnë të kënaqin në rrethin e tyre. Ajo përfshinë kërkimin për nevojen dhe kuptimin e jetes personale, për përgjigjet në çështje të mëdha të jetes, dëshirën për rëndësinë, ndjenjen personale të vlerave dhe dinjitetit në sytë e tjerëve. Trauma personale, turpi, poshtërimi dhe abuzimi i perceptuar nga ana e shoqërisë mund të nxisë këtë lloj ndjenje të humbjes së vlerave personale. Individet të cilët kanë pas këto eksperiencë mund të përfitojnë nga këto faktorë për të ripërtri ndjenjen e vlerës së vet dhe identitetin e qartë të cilët radikalizuesit u premtojnë. Materiali për regrutim⁴, nga ana tjetër, shpesh përkujton poshtërimin dhe vuajtjet e muslimanëve në tërë botën dhe përfaqësojnë xihadin si rrugë që përsëri të arrisin rëndësinë. Me fjalë tjera, organizatat teroriste premtojnë ndjenjen e kuptimit, arritjen e njohjes dhe status për të gjithë të cilët punojnë në emër të tyre dhe me këtë në mënyrë direkte perdorin ekzistimin e faktorëve largues.

3 http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PNADT977.pdf

4 Al Kaida dhe të tjerët

Ndër faktorët largues, një segment i cili u hapë dyert radikalizuesve është edhe pakënaqësia politike e theksuar të disa personave të ndjeshëm. Ata janë deri në atë masë të pakënaqur me partitë ekzistuese dhe mosbesues ndaj sistemin politik, që përgjithësisht refuzojnë të besojnë se diçka bëhet për të mirën e tyre ose thjesht konsiderojnë se ajo çka bëhet nuk është e mjaftueshme. Ata nuk ndjejnë se dikush i dëgjon, nuk kanë mënyra të shprehin ankesat e tyre dhe ndjehen të pafuqishëm dhe të paaftë që të ndikojnë në ndryshime dhe në atë se çfarë ndodh në jetat e tyre. Janë të irituar sepse ndjehen të paaftë të marrin pjesë në proceset politike dhe konsiderojnë se askush nuk punon për ta. Fakti se ekstremistet e dhunshëm refuzojnë metodat ekzistuese të pjesëmarrjes politike atyre do tu duken më tërheqëse.

Faktorët tërheqës (pull) e bëjnë ekstremizmin tërheqës, si për shembull, ekzistimi i grupeve ekstremiste të organizuara mirë me diskurse pranuese dhe programe efikase. Këtu bëjnë pjesë edhe përfitimet personale, që anëtarësia në grupe ekstremiste premtan përmes rrefimëve manipulative dhe taktikave regrutuese. Këta faktorë përfshijnë: statusin shoqërorë, respektimin e moshatarëve, vetëbesimin, perspektiven e arritjes së lavdisë, forcimin personal, ndjenjen e përkatësisë, marrëdhëniet personale, liderit tërheqës, duke përkrahur rrjetin shoqëror, regrutuesit harizmatik, hakmarrjen për padrejtësitë e bëra apo perceptuara, plotësimin shpirtërorë, të ardhurat dhe punësimin, avanturat, liritë dhe kështu me rradhë.

Nuk duhet të nënvlerësohen as faktorët ideologjik. Thirrja në koncepte ose ngjarje të cilat rrjedhin nga

traditat e hershme religjioze për transmetimin apo legjitimimin e kërkesave moderne kthejnë religjionin dhe ideologjinë në faktor të fuqishëm tërheqës. Shumë terrorist të intervistuar gjithashtu kanë deklaruar se u janë përgjigjë thirrjes shpirtërore dhe ndjenjës së entuziazmit shpirtërorë apo varësisë në lidhje për përfshirje në grupet ekstremiste. Personat e radikalizuara shpesh kanë qenë të tërhequra me superioritetin e vlerave të reja të cilat u janë ofruar dhe premtimin e superioritetit personal nëse bëhen pjesë e ekstremistëve. Individët gjithashtu mund të shikojnë në botë si në sistem represiv dhe obligohen që ta shkatërrojnë. Në lidhje me rolin e ideologjisë, trashëgimia historike e sundimit të huaj dhe mundimi mund të mundësojë më lehtë zhvillimin e tregimeve në lidhje me viktimizimin e grupit të synuar dhe të rrisë tërheqjen e tyre..

Faktorët tërheqës janë njëjtë të rëndësishëm si dhe faktorët largues sepse e përfshijnë individin në organizata ekstremiste, e mbajnë atje dhe e radikalizojnë.

Faktorët kontekstual përbëjnë fushë të favorshme për lajmërimin e grupeve ekstremiste të dhunshme dhe përfshijnë: kriminalitetin, administratën e dobët, ofrimin jo adekvat të shërbimeve publike, represionin e qeverisë dhe shkeljen e të drejtave të njeriut, shtetin e dobët me shërbime sigurie joefikase, konfliktet lokale, lajmërimin e oazës kriminale-sferat e administruara keq apo mjediset e izoluara, regjimin e diskredituar me opozit e cila nuk ekziston ose është e dobët, demokracinë e dobët, korrupsionin dhe mosgjobitjen e elites, finansimin shtetërorë të grupeve ekstremiste, etj.

Procesi i radikalizimit dhe rruga drejt ekstremizmit do të jenë të ndryshme për çdo individ, por të gjitha këto kategori do të jenë të pranishme. Ndërveprimi kompleks dhe specifik për kontekstin midis faktorëve shpjegon se si grupe të ndryshme ekstremiste ishin në gjendje të rekrutinin njerëz nga prejardhje krejtësisht të ndryshme. Për këtë, çelësi për zbulimin e aktivitetëve ekstremiste dhe rrëfimet të cilat do të arrisin të formojnë radikalizimin në popullësi qëndron në kuptimin se cila nga kjo temë do të arrijë pranim pozitiv, në cilin mjedis dhe në cilin moment. Për shembull, disa faktorë lokal individual mund të bëjnë personin e ri më pranues në mesazhet ekstremiste. Ato mund të jenë problemet në sjellje apo familje, pakënaqësia në statusin personal apo përfshirjen në kriminalitet. Procesi i radikalizimit atëherë mundëson që ideologjia ekstremiste të jetë tërheqëse dhe e besueshme për personin e ri, shpesh për asrye se duket se ofron zgjidhje për ndjenjen e mohimit dhe padrejtësisë së perjetuar. Zakonisht, ekziston individi harizmatik apo atraktiv i cili radikalizon dhe inkurajon personin që të zhvillojë edhe marrë bindje ekstremiste. Më në fund, shpesh mungesa e faktorëve pozitiv përkrahës të cilët do të mundësonin mbrojtjen e të rinjëve nga radikalizimi – siç është rrjeti i përkrahjes në familje dhe ndërmjet shoqërisë apo mësimdhënësi i cili e vëren problemin dhe intervenon që ti ndihmojë. Natyrisht, në një rast tjetër individual, gjërat do të kenë kahje komplet tjetër. Nuk duhet të harrohet se në rrugën drejt radikalizimit do të ekzistojnë plotë faktorë dhe dallime individuale si dhe lokale dhe dallime të ndryshme ndërmjet levizjeve radikale dhe ekstremiste. Ajo që motivon individet dhe komunitetet që të pranojnë grupe ekstremiste të dhunshme, gjithmonë

do të varen nga konteksti lokal në momentin konkret, çka edhe shpjegon pse ekstremistët kanë arritur sukses në regrutimin e personave krejtësisht të ndryshme.

Shqyrtimi i kësaj ndarje të faktoreve radikalizues në largues, tërheqës dhe kontekstual është shumë i rëndësishëm për dizajnimin e intervenimit. Lufta kundra ekstremizmit të dhunshëm ka për qëllim që të ndalojë përhapjen e grupeve aktive ekstremiste dhe të përmirësojë parandalimin e pranimin të ekstremizmit përmes zvogelimit të lëndueshmërisë së grupeve të indentifikuara. Ashtu puna në faktorët largues në thelb do të thotë plotësimin e nevojave dhe zgjedhjen e problemeve elementare të personave të lëndueshëm të cilët ekstremistët e dhunshëm do të kenë mundësi ti shfrytëzojnë për radikalizim. Puna në faktorët tërheqës do të thotë, ngadalsimin e taktikave të shtremberuara të regrutuesve të cilët ushtrojnë ndikim në komunitet dhe qëllojnë individ të lëndueshëm, ndërsa mediumet dhe komunikimi janë me rëndësi kyçe për këtë përgjigje. Faktorët kontekstual gjithashtu mund të zbusin intervenimet e ndryshme të drejtuara në përmirësimin e demokracisë, administratës, policisë, reprezentimit politik, ndertimin e besueshmërisë ndërmjet komuniteteve lokale dhe qeverisë, në promovimin, luftën kundër korupcionit, etj.

Si edhe puna me persona të lëndueshëm gjithashtu dhe puna në faktorët radikalizues kërkon kujdes të veçantë, senzibilitet kulturor, respektimin e dallimeve kulturore në komunitete të njëjta, shmangjen e stigmatizimit dhe etiketimit të pakicave dhe komunitetëve dalluese.

Radikalizimi si proces

Siç është treguar deri tani më funksionale, radikalizimi më së miri mund të shikohet si proces i ndryshimit personal apo politik nga një gjendje në gjendje tjeter. Ekzistojnë disa modele të procesit radikalizues⁵ të cilët përshkruajnë fazat e ndryshimit të cilat personi i perjeton nga momenti kur është shënjestruar nga ana e radikalizuesit dhe lëndueshmërinë në ndikimet e tyre deri tek anëtarësimi aktiv dhe kontributi në grupet ekstremiste.

Proceset e modeleve të ndryshme shfaqin dukshëm fazat e ndryshme të radikalizimit. Nga ana tjetër, ekzistojnë edhe rezultatet e përbashkëta dhe kuptimet ndërmjet modelëve të ndryshme. Ashtu që, edhe pse hulumtuesit e ndryshëm kanë identifikuar faza të ndryshme në procesin e radikalizimit, të gjitha studimet pajtohen se ekzistojnë faza individuale të ndryshimit (për shembull rritja e besimit, kërkimi për identitet) të cilat stimulohen përmes aspekteve të jashtëm (për shembull perjetimi i diskriminimit apo rasizmi, apo sulmi i perceptuar në grupin e vet) dhe çonë në kalim të radikalizimit të dhunshëm, i cili zakonisht ndodhë kur individi shoqërohet me persona të cilët kanë të njëjtin mendim. Gjithashtu, hulumtimet tregojnë se radikalizimi është, për shumicën e njerëzve, proces gradual, që kërkon progres përmes fazave të ndryshme dhe nuk ndodhë as shpejtë as lehtë. Personi, ashtu, nuk mund të radikalizohet për një ditë. Të gjithë modelët e procesit tregojnë se

radikalizimi është, si rregull, proces afatgjatë prej disa viteve deri bile edhe me shumë se një dekadë. Ajo që drejton në kujdes janë rezultatet e rasteve, të ashtuquajtura “ngjarje katalizuese” (vdekja e personit të dashur, diskriminimi i perjetuar) ku procesi i radikalizimit mund të jetë shumë më e shpejt, si dhe në disa raste, ku nga faza përfundimtare e radikalizimit, deri në vetë aktin e kryerjes së një akti terrorist, radikalizimi mund të përshkallëzohet shpejt dhe të zgjasë vetëm disa javë.

Mbrenda modeleve të procesit, fazat nuk janë domosdoshmëri sekvenciale dhe mund të përputhen, perzihen dhe të zgjasin për periudha të ndryshme. Gjithashtu, kalimi përmes të gjitha fazave nuk është aspak i domosdoshëm. Nuk kanë perparuar të gjithë në mënyrë të njëjtë të cilët kanë filluar procesin e radikalizimit përmes të gjitha fazave dhe ka mundësi që të ndalohen ose të tërhiqen plotësisht nga procesi i radikalizimit në pika të ndryshme. Kjo do të thotë se personi ka mundësi që plotësisht të kapercej fazen me të cilën arrin deri tek veprimi militant ose mund të dëshpërohet në cilën do fazë tjetër të radikalizimit dhe ta lëshojnë krejt procesin.

Akumulimi i dijes pra, për të gjitha pikat e lartë përmendura dhe për arsye që edhe në sferën e vëzhgimit të radikalizimit si proces, nuk është i mjaftueshëm, as mjaft e verifikuar shkencatarisht që të mundësojë prurjen e përfundimëve dhe për këtë arsye këtu është i nevojshëm kujdesi, si dhe fleksibiliteti në zbatimin e këtyre modeleve.

5 http://www.safecampuscommunities.ac.uk/uploads/files/2016/08/yjb_preventing_violent_extremism_systematic_review_requires_uploading.pdf

Shenjat e hershme të radikalizimit dhe ekstremizmit

Radikalizimi, siç është theksuar edhe më heret, është proces, e jo vetëm një ngjarje. Ajo ndonjëherë mund të ndodhë në mënyrë të shpejtë, por më shpesh do të kërkojë kohë më të gjatë. Kjo jep mundësi për identifikimin e hershëm të rrezikut dhe për zgjedhjen më të mirë për intervenim, që personi të mbrohet nga radikalizimi. Nëse dëshironi të punoni në komunitetin tuaj në adresimin e radikalizimit dhe ekstremizmit ose thjesht jeni të brengosur që dikush të cilin e njihni mund të jetë i tërhequr nga grupi radikal, mundeni të kërkon disa shenja të paralajmërimit.

Shenjat e mëposhtme janë identifikuar si shenja të mundshme të radikalizimit potencial dhe sa më shumë që shfaqen në kombinim, janë tregues më të fortë:

- Humbja e interesimit dhe distancimi drastik dhe i papritur nga aktivitete të më hershme, nga familja dhe shoqëria të cilët nuk kanë lidhje me qendrimet dhe grupet ekstremiste;
- Shoqëria e re e cila ka ndikim negativ në ta dhe fshehja e identitetit të tyre;
- Fshehtësia dhe shmangja për të folur për aktivitetet e veta, për levizje dhe për shoqëri;
- Kalimi i kohës të tepërt në internet apo celular, ndërrimi i identitetit on-line;
- Posedimi i celularve (të ri) apo pajisjeve tjera, ruajtja dhe

fshehja e tyre;

- Ndryshimi i papritur, drastik, në pamjen apo veshjen në drejtim të kërkesave të grupeve ekstremiste;
- Humbja e papritur e interesimit për shkollë, ulja e suksesit në shkollë, konflikte në shkollë apo lëshimi i shkollës;
- Ndryshim i pergjithshëm në qëndrime dhe sjellje të cilat kanë të bëjnë me ushqimin, gjuhen dhe finansat, p.sh. harxhim apo kursim i papritur;
- Aktivitetet e perdritshme më shumë koncentrohen rreth ideologjive dhe grupeve ekstremiste;
- Ndryshime në sferen sociale: komente antisociale, refuzimi i autoritetit, refuzimi i interakcionit shoqërorë, terheqja dhe izolimi;
- Shfaqja e identifikimit me grupe-ideologji ekstremiste. "Ne" - personi e përdorë kur flet për vehten dhe për grupin ekstremist dhe nuk e përdor për identifikim me të gjitha grupat tjera;
- Përdorimi i literaturës dhe materialit ekstremist, vizita e veb-faqeve dhe pjesëmarrja në rrjetet sociale ekstremiste;
- Përpjetja e propagandës terroriste dhe ekstremiste në rrjetet sociale;
- Fillimi i përdorimit "ne dhe ata" në shprehje, fraza ofenduese për tjerët cilët janë të ndryshëm, refuzimi i kontakteve me ta ose agresiviteti ndaj tyre, ndonjëherë në bazë të racës, religjionit, gjinisë apo seksualizmit;
- Identifikimi i qartë i grupit tjetër si rrezik për atë që avokon

dhe fajësimi i atij grupi për çdo problem shoqërorë dhe politik;

- Bindjet për pashmangshmërinë e sulmit nga ana e grupit tjetër dhe rëndësia e veprimit urgjent;
- Lajmërimi i ndjenjes së persekutimit;
- Lajmërimi i mosbesimit në mediat e pranuar dhe interpretimet e tyre dhe hapja për teori konspirative dhe apokaliptike;
- Lajmërimi i interesimit të papritur për politikë, posaçërisht për politiken e jashtme dhe shprehjen e mosbesimit dhe zemërimit për ato;
- Fillimi i deklaramentit të simpative ndaj ekstremistëve dhe pamjeve radikale, arsytimi i veprimëve të tyre, promovimin e qëndrimeve ekstremiste, veprimeve dhe mjetëve të dhunshme;
- Mbajtja e kontaktëve me rekrutuesit ekstremist dhe bashkangjijtja apo tentimet për bashkangjijtje në grupet ekstremiste;
- Tentimet që të rekrutohen të tjerët për ideologji ekstremiste;
- Miratimi, përkrahja dhe avokimi i dhunës ndaj të tjerëve;
- Planifikimi i konspiracioneve, planëve me ekstremistet kundër grupeve tjera;

- Përgaditja për tu dhënë lamtumirën të tjerëve.

Kjo nuk është lista perfundimtare e cila do të garantojë vlerësimin e besueshëm të rreziqëve, por është tregues i një serë shenjave të mundshme të radikalizimit, të cilët mund të ndihmojnë në vendimin për nevojën e mbledhjeve të informacioneve plotësues, konsultimit me prindërit, mësimdhënësit dhe personat tjerë të afërm. Gjithashtu, këto nuk janë shenjat definitive të radikalizimit apo ndjeshmërisë në radikalizem. Ndonjëherë ekzistojnë shenja të qarta të paraljmërimit. Në rastet tjera ndryshimet janë më pak të dukshme, posaçërisht nëse grupi radikal kërkon fshehtësi nga anëtarët e tij.

Praktikisht, të gjitha këto shenja, posaçërisht nëse merren ndamas, mund të jenë të shkaktuara nga faktorë të jashtë të shumtë të radikalizimit, siç është kriza jetësore, faza e zhvillimit (posaçërisht tek të rinjtë), keqpërdorimi i drogave dhe alkoolit, problemet në familje, dhuna ndërmjet moshatarëve dhe për këtë është shumë me rëndësi mos të reagoheret heret dhe në mënyrë të tepërt që mos të nxitet stigmatizimi, ose rrezikimi dhe viktimizimi i personit të rrezikuar.

Disa qasje⁶ në identifikimin e treguesve të hershëm të radikalizimit ndahen në tri kategori:

⁶ http://course.ncalt.com/Channel_General_Awareness/O1/resources/docs/vul-assessment.pdf

- **Treguesit e përfshirjes** në ideologjinë ekstremiste, temat apo grupet, pranimi, interesimi për to (disa tregues të mundshëm për këtë kategori janë në gjysmën e parë të listës së mëparshme);
- **Treguesit e qëllimit që të shkaktojnë dëme** ndonjë grupit - nuk vazhdojnë të gjithë ata të cilët përfshihen në ideologjinë ekstremiste, temë apo grup të zhvillojnë qëllime për dëmtimin e ndonjë grupi tjetër, për këtë arsye ky dimenzion konsiderohet veçmas. Treguesit e qëllimit përshkruajnë mënyrën e të menduarit që është e nderlidhur me gatishmërinë që të perdoret dhuna (treguesit e mundshëm për këtë kategori janë në gjysmën e dytë të listës së mëparshme);
- **Treguesit e aftësisë për shkaktim të dëmit**, nuk janë të gjithë ata të cilët kanë dëshirë që të dëmtojnë në emër të grupit apo ideologjisë ekstremiste, të aftë që të bëjnë dëm. Gjithashtu, planet për të shkaktuar dëm të madh kërkojnë nivel të lartë të aftësive dhe resurse që të jenë të suksesshëm. Pra është e rëndësishme që të analizohet se çka është individi i gatshëm të bëjë kur vlerësohet rreziku për publikun. Treguesit e kësaj kategori mund të përfshijnë: dijen individuale, kompetencat dhe aftësitë, qasjen në rrjete, mjetet dhe pajisjet dhe aftësitë kriminele.

Kjo qasje mund të jetë e dobishme jo vetëm në zbulimin e hershëm të radikalizimit, por edhe në vlerësimin e fazës së radikalizimit në të cilën personi vulnerabil gjindet, por edhe atë duhet ta perdorim me senzibilitet të posaçëm që personat e ndjeshme mos të rrezikohen edhe më shumë.

Udhëzime praktike për veprim në raste konkrete

Prindërit dhe familja janë më të afermit dhe mbrojtësit më të mirë të fëmijëve dhe të rinjve nga rreziku i radikalizimit. Ata e njohin fëmijen e vet më së miri, janë në kontakt të përditshëm me të dhe kanë mundësinë e bashkëpunimit me shkollën dhe institucione tjera në komunitet, si dhe mundësinë e kontaktit me bashkëmoshatarët e fëmijëve të vet, ashtu janë në pozitë që më së pari të vërejnë ndryshimet tek fëmijet e vet dhe të ndajnë se çfarë është pjesë e rritjes, e çka është pasoja eventuale e ndikimeve negative në fëmijë. Gjithashtu, prindërit janë më të ftuarit dhe në pozitë që të reagojnë nëse vërejnë se fëmija i tyre është i rrezikuar dhe të kërkojnë përkrahje për këtë. Prindërit dhe familja mund tu ndihmojnë fëmijëve dhe të rinjve që të mbrohen nga radikalizimi në shumë mënyra, si për shembull:

- Të njoftohen me proceset dhe mënyrat e veprimit të radikalizuesve, pranisë eventuale të grupeve ekstremiste në komunitet, punën e organizatave dhe institucioneve të cilat ofrojnë përkrahje familjeve në mbrojtjen nga radikalizimi dhe mënyrave me të cilat ata mund ti përkrahin dhe mbrojnë fëmijet e tyre;
- Të njoftojnë fëmijen e vet për rreziqet e radikalizimit, posaçërisht me taktikat manipuluese dhe propagandistike të grupeve ekstremiste dhe të forcojnë fëmijen e vet që të ketë mendim kritik ndaj atyre tentimeve dhe të kërkojnë përkrahjen e familjes nëse dikush i afrohet me atë qëllim;

- Të mbajnë komunikim të hapur dhe sinqertë me fëmijen e vet, të ndëgjojnë fëmijen e vet dhe të flasin me të për interesat e tij, si dhe të formojnë lidhjen e besimit dhe përkrahjes, në të cilën fëmija gjithmonë do të mund të drejtohen për ndihmë pa frigë nga gjoba apo kritika;
- Të ndihmojnë dhe përkrahin fëmijen në zhvillim dhe në zgjedhjen e problemeve, në mënyrë që të ndikojnë në zvogëlimin e lëndueshmërisë së tij dhe forcimin e rezistencës në tentimet radikalizuese;
- Të edukojnë fëmijet për vlerat pozitive, vlerat e tolerancës, barazisë, respektimin e diversitetit, të drejtave dhe lirive njerëzore, bashkëjetesën e përbashkët, etj. jo vetëm deklarativisht, por në mënyrë aktive - përmes jetës në familje e cila do të sjellë në përputhshmëri me këto vlera dhe përmes sjelljes së vet e cila do të pasqyrojë vlerat pozitive;
- Të percjellin bashkë me fëmi përmbajtjet informative, të flasin me fëmijë për atë se çka shikojnë në televizion apo internet, e posaçërisht tu theksojnë dëmin, të pa vërtetat dhe narativet ekstremiste manipuluese të cilat paraqiten;
- Të mundësojnë dhe inkurojnë bisedat me fëmijë dhe pyetjet për ngjarje lokale dhe botërore dhe tu ndihmojnë që të shikojnë imazhin e plotë të ngjarjeve dhe të mendojnë në mënyrë kritike për këto tema;
- Të jenë të njoftuar për levizjen e fëmisë, me kë shoqërohet dhe si e kalon kohën, por edhe të njoftojnë shokët e fëmisë e eventualisht edhe prindërit e tyre;
- Të jenë të njoftuar me on-line dhe aktivitetet e fëmisë së tyre në rrjetet shoqërore dhe të mësojnë sa më

shumë për përdorimin e këtyre kanaleve të komunikimit, përkatësisht edhe të mësojnë dhe bindin fëmijnë e tyre të përdorin internetin në mënyrë të sigurtë, por edhe të reagojnë nëse vërejnë se fëmija i tyre është i ekspozuar materialeve ekstremiste ose veprimet të radikalizuesve;

- Të inkurajojnë fëmijnë e tyre të tregojnë interesim për komunitetin lokal, duke respektuar njerëzit e të gjitha besimëve dhe prejardhjeve, si edhe të përfshihen në aktivitete pozitive me grupet lokale të cilave mund të besojë;
- Të mësojnë fëmijnë se në cilat mënyra mund të shprehin qendrimit e forta dhe të provojë të ndryshojë gjërat në kahjen më të mirë, por mos të ndër marrë veprime dhune kundra të tjerëve ose të përkrahin ata të cilët veprojnë dhunshëm;
- Nëse kanë ndonjë frigë se në fëmijë dikush ndikon, të kërkojnë ndihmë dhe përkrahje-të bisedojnë me dikë që mund ti besojnë.

As kjo, sigurisht, nuk mund të jetë lista perfundimtare e opsioneve të cilat prindërit dhe familjet i kanë në mbrojtjen e fëmijëve nga radikalizimi sepse çdo fëmi do të jetë i lëndueshëm në mënyrë të vetë, e tentimet për radikalizim do të jenë shumë të përshtatura, gjithmonë të ndryshme dhe të përshtatura me qëllim që të kenë sukses në terheqjen e fëmisë konkret. Nga ana tjetër, propozimet e ofruara japin bazë të gjërë për parandalimin e mekanizmave bazë për manipulime radikalizuese, e ajo është shfrytëzimi dhe perforcimi i vulnerabilitetit të fëmisë, ta ndajë dhe kthejë kundra familjes me qëllim që ta drejtojnë në qëllimet e veta ekstremiste.

Roli i arsimit dhe institucioneve arsimore në luftë kundër radikalizimit edhe ekstremizmit është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Vetëm disa vjet më parë është pranuar globalisht, pra në dokumenta kyç të KB gjinden udhezimet dhe obligimet e këtij llojit⁷. Këto dokumente theksojnë se arsimit duhet të⁸:

- Ndhimjnë të rinjët që të avancojnë komunikimin dhe aftësitë ndërnjerëzore të cilat janë të nevojshme për dialog, ballafaqim me mospajtimin dhe mësimin e qasjes së qetë në ndryshime;
- Ndhimjnë nxënësit që të zhvillojnë mendimin e vet kritik që të hulumtojnë pretendimet, verifikojnë thashethemat dhe të bjenë në pyetje legjitimitetin dhe terheqjen e bindjeve ekstremiste;
- Ndhimjnë nxënësit që të zhvillojnë rezistencën që tu rezistojnë elementeve ekstremiste dhe të arrisin aftësitë socio-emosive të cilat u janë të nevojshme që të kapërcejnë dyshimet e veta dhe të kyçen në mënyrë konstruktive në shoqëri pa nevojë për dhunë;
- Nxisin qytetarët kritik të informuar të cilët janë në gjendje që të angazhohen konstruktivisht në veprime kolektive paqësore.

Për të përmbushur rolin e vet në parandalimin e ekstremizmit

7 Plan of Action to Prevent Violent Extremism. Report of the Secretary-General (A/70/674) http://www.un.org/en/sc/ctc/docs/2015/SCR%202178_2014_EN.pdf, United Nations Security Council Resolution 2178, adopted in September 2014, http://www.un.org/en/sc/ctc/docs/2015/SCR%202178_2014_EN.pdf, UN Security Council Resolution 2250, adopted in December 2015, <http://un.org/wp-content/uploads/SCR-2250.pdf>, Decision 46 adopted at the 197th session of UNESCO's Executive Board (197 EX/Decision 46) <http://unesdoc.unesco.org/images/0023/002351/235180e.pdf>

8 Perkthyer dhe adaptuar nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000244676>

të dhunshëm, arsimit duhet të fokusohet përmes punës edukativo-arsimore në arritjen e qëllimeve të mëposhtme tek të rinjët⁹:

Sfera kognitive e të mësuarit:

- Zhvillimi i aftësive të mendimit kritik dhe analizes
- Arritjen e dijes dhe kuptimit të çështjeve lokale, kombëtare dhe globale si dhe lidhjen dhe varësinë ndërmjet shteteve dhe banorëve të ndryshëm

Sfera socio-emosive e mësimin:

- Zhvillimin e ndjenjes së përkatësisë së përbashkët të njerëzimit dhe ndjenjen se ndajnë vlerat dhe përgjegjësitë e bazuara në të drejtat e njeriut
- Zhvillimin e empatisë dhe solidaritetit
- Zhvillimin e respektimit të diversitetit dhe dallimëve
- Ndertimin e kompetencave interkulturore

Sfera bihejviorale e mësimin:

- Fitimin e aftësive efikase dhe përgjegjëse në paraqitje gjatë bisedave
- Fitimin e aftësive të bindshmërisë në shprehjen e qëndrimeve të veta
- Fitimin e aftësive për zgjedhje pozitive të problemeve
- Zhvillimin e motivimit dhe gatishmërisë që të ndermarrin veprimet e nevojshme

9 Perkthyer dhe adaptuar nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000244676>

Organizimi i diskutimeve për ekstremizem dhe radikalizem në shkollë¹⁰

Për udheheqjen e suksesshme të diskutimeve të cilat do të arrijnë qellimet e caktuara dhe mos të shkaktojë dëme në cilin do aspekt të pjesëmarrës, **përgaditja e mirë** është e nevojshme. Përgaditja duhet të përfshijë: përcaktimin e qellimeve të mësimit, temes, qasjes dhe mesazhet kyçe të cilat janë të nevojshme të percjellen në bisedë; fitimi i lëjes së nevojshme dhe perkrahjen e udheheqesisë së shkollës; njohja themelore me temen dhe faktet nga konteksti lokal; përgaditjen emotive dhe profesionale; thirrja e ligjeruesve mysafirë ose ndermjetësuesit nëse vlerësohet se është e nevojshme. Për të përgaditur diskutimet në këto tema shumë të ndjeshme do të ishte e dobishme që përpara të mendohet dhe analizohet se kush do të mund të ishte i diskriminuar apo të ndjehet i rrezikuar gjatë diskutimit, të pakten indirekt ose implicit dhe përpara të mendohen mënyrat që të parandalohet dhe ndalohet një gjë e tillë.

Përcaktimin e **momentit të duhur dhe pikave fillestare** për trajtimin e ekstremizmit të dhunshëm në klasa është me rëndësi të veçantë. Për mësime dhënësit të cilët planifikojnë orët e para të perkushtuara kësaj teme u propozojmë planifikimin paraprak dhe orët e ndara të shpallura për këtë temë, në mënyrë që të mund ti realizojnë përgaditjet paraprake sa më lehtë. Për mësime dhënësit të cilët veç kanë eksperiencë në udheheqjen e diskutimeve në këto tema

sfiduese, perdorimi i „momenteve për mësim“ (*teachable moments*) do të jetë shumë më efektiv dhe natyror. Fjala është për rastet e paplanifikuara të cilat duhet të perdoren që të shpjegohet koncepti i vështirë ose për fillimin e bisedës i cili do të lidhë temen e ekstremizmit të dhunshëm me eksperiencat e nxënësve.

Që diskutimi të zhvillohet në mënyrë konstruktiv dhe të sigurtë, në mjedis jo diskriminues dhe perkrahës në të cilin nxënësit respektojnë njëri tjetrin është shumë me rëndësi të vendosën **rregullat**. Ndër rregullat më të shpeshta dhe me të nevojshmet për këtë llojë diskutimit janë: ndëgjoni me vëmendje pa gjykime, lirshëm kërkoni sqarime, kritikoni komentet, idetë apo qendrimet e jo personin i cili i shpreh, jeni të gatshëm të pranoni informacionet kthyesë ose kritikën për idetë tuaja, të jeni tolerant për qendrimet të cilat dallohen nga qendrimet tuaja, perdorni vetem gjuhën e cila është plotë respekt dhe nuk thërret në urrejtje, përfshini të gjithë në debatë, përmbajuni temes dhe le të jenë komentet e shkurtra.

Gjatë **diskutimit**, mësime dhënësi ka disa detyra të rëndësishme: udheheqjen gjatë diskutimit, parashtrimin e pyetjeve në mënyrë që nxënësit të analizojnë edhe pamjet alternative, definimin e mënyrës së parashtrimit të pyetjeve dhe dhënien e pergjigjes në mënyrë që ti drejtojnë nxënësit gjatë diskutimit, të ndëgjojë nxënësin aktivisht dhe pa gjykime, të mundësojë që edhe ata njëri tjetrin ta ndëgjojnë, të ndihmojnë nxënësit që ti gjejnë fjalët që të shprehin mendimet e tyre, të kujdesohen që argumentet e ndryshme të ndëgjojnë në debatë, të ndalojnë komentet dhe

¹⁰ Perkthyer dhe adaptuar nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000244676>

reakcionet diskriminuuese dhe agresive, të mundësojë respektimin e rregullave të përcaktuara për diskutim, të kujdesen që asnjë grup mos të jetë i perjashtuar nga debata dhe të ndjehen të gjithë të sigurtë për pjesëmarrje, të sqarojnë dilemat dhe konceptet, të mbydhin diskutimet, të arrisin qellimet e caktuara.

Mbas debates për çështje kontroverze, është e nevojshme të ceket dhe percjellen mesazhe pozitive në mënyrë që nxënësit të bashkohen rreth vlerave të përbashëta. Kjo është e rëndësishme që klima në klasë të jetë produktive dhe nxënësit të ndihen të sigurtë. **Mesazhet kyçe** të propozuara për diskutim në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm përfshijnë: solidaritetin, respektimin e diversitetit, drejtave të njeriut, të mësojnë si të jetojnë bashkë, angazhimin e të rinjëve në akcione lokale.

Edhe për situatat e mundshme të krizës dhe paqartësive të cilat do të mundën të ndodhin gjatë organizimit të diskutimeve të ndjeshme mundemi të përgaditemi më heret. Në vazhdim janë të propozuara opsionet dhe këshillat për situata potenciale të ndjeshme.¹¹

A duhet të merremi me tema të tilla të ndjeshme në orë?

- Absolutisht po. Informacionet për radikalizem dhe ekstremizem gjithsesi do të arrijë deri tek nxënësi përmes kanaleve tjerë të komunikimit dhe socializimit, ashtu që shmangja e tyre në shkollë nuk i mbron nxënësit në ballafaqimin me tema të ndjeshme. Perkundrazi, i bën më vulnerabil sepse në këtë mënyrë vetëm pamundëson që të rinjtë të njoftohen me informacione relevante dhe për ato të mëndojnë në mënyrë kritike.
- Duke ju falenderuar qasjes së madhe të të rinjëve në teknologji informativo-komunikative, mësimdhënësit dhe prindërit mund

të jenë vetëm të surprizuar me shkallen me të cilën fëmijët janë të ekspozuar me çështje të ndjeshme dhe masën me të cilën janë të njoftuar me ngjarjet kontroverze botërore. Organizimi i diskutimeve në shkollë në këto lloj temash mund të ndihmojë në identifikimin e konfuzioneve dhe ndikimet manipulative tek të rinjtë.

- Nëse shkollat do të shmangnin këto tema, nxënësit sigurisht do të përpiqeshin që vet ti gjejnë përgjigjet, dhe mund të hasin edhe në burime të gabueshme informacionesh dhe qasje të gabueshme ose bile edhe të vëhen në dukje ndikuese të radikalizuesit.
- Mësimdhënësit duhet të ndërtojnë mjedis të sigurtë dhe konstruktiv për dialog në klasë dhe të sigurojnë që nxënësit të ndihen të sigurtë dhe të besojnë se mësimdhënësit dhe organet e shkollës kanë ndëgjuar dhe marrë parasysh pyetjet dhe frigën e tyre. Kjo do të nxisë nxënësit që të marrin pjesë në diskutime që ti zgjidhin problemet dhe dilemat e tyre. Ndërtimi i besimit është kyç në konsiderimin e çështjeve ndjeshme dhe paraqet hap drejt shmangjes së marginalizimit.

Nëse në klasë ka nxënës nga komuniteti pakicë të cilët mund të jenë të stigmatizuar pa arsye si pjesëmarrës në ekstremizmin e dhunshëm, a është ende e pershtatshme të flitet në atë temë?

- Absolutisht po, por duhet të bëhet me shumë kujdes dhe me përgaditje themelore.
- Debati duhet të jetë i balansuar.
- Me rëndësi kyçe është që nxënësit nga grupet pakicë të cilët janë prezent në orë të mos indentifikohen me autorët e ekstremizmit të dhunshëm të cilët i përkasin të njëjtit grupë pakicë-etnie.

¹¹ Përkthyer dhe adaptuar nga <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000244676>

Theksoni identitetin personal në krahasim me identitetin e grupit, si dhe nevojen që secili individ të rrespektohet.

- E dobishme është të shqyrtohet problemi i stigmatizimit të padrejtë e cila nganjëherë është e drejtuar ndaj krejt grupit të pakices mbas akteve ekstremiste të cilat i ndërmarrin një apo dy individ të cilët janë të lidhur me atë grup. Nxënësit duhet ta kuptojnë padrejtësinë të cilën pa vetëdije mund tu shkaktojnë njerëzve të pafajshëm përmes etiketimit dhe perjashtimit.
- Në fillim të debates, mësimëdhënësi duhet të theksoj se ekstremizmi i dhunshëm nuk është i kufizuar në rasë, religjion, etni, gjini apo grup politik.

Diversifikimi i shembujve të ekstremizmit të dhunshëm në drejtim të prejardhjes së autorëve është kyç.

Si të ndalohet konflikti i nxënësve me qendrimet e ndryshme gjatë dhe mbas diskutimit në klasë?

- Për këtë është e nevojshme faza përgaditëse për nxënësit dhe mësimëdhënësit. Në atë fazë mësimëdhënësit duhet të analizojnë mirë burimet e mundshme të konfliktit dhe agresionit në diskutim dhe të përgadisnin opsionet për parandalimin dhe ndalimin e tyre.
- Në kuader të përgaditjes, nëse rreziku nga lajmërimi i është i lartë, është e mundshme të organizohet diskutimi fillestar në grupe më të vogla në mënyrë që edhe nxënësit të përgaditen, mandej në mënyrë të shkallëzuar të bashkohet grupi kur rreziku nga konflikti është eliminuar.
- Është e nevojshme që në fillim të definohen rregullat elementare dhe mësimëdhënësi duhet të caktoj kufijtë e qartë se çka është e lejuar, e çka jo. E dëshirueshme është

që edhe nxënësit të kyçen në prurjen e rregullave në mënyrë që të forcohet motivimi i tyre që ti rrespektojnë. Gjatë diskutimit, mësimëdhënësi do të duhet ti perkushtonte vemendje të veçantë në rrespektimin e rregullave, e më mirë nëse ka mundesi që edhe rrespektimin e rregullave ti bëjë participative, pra të kyçin edhe nxënësit.

- Shumë e rëndësishme është që diskutimi për ekstremizem të dhunshëm në këto kushte të udhëhiqet me strukturë, që të shmangët mundesia e konfliktit dhe të sigurojë që qellimet e diskutimit të arriten.
- Përjetimi i debates si proces i hapur dhe demokratik i cili të gjithë nxënësit i trajton barabartë ka kuptim aq sa ka edhe përmbajtja reale e debatit. Nëse të gjithë nxënësit e dinë se qendrimet e tyre janë ndëgjuar dhe rrespektuar, mundësia është më e vogël që mbas saj të ndahen në grupe.
- Gjatë debatit mund të lajmërohet edhe momenti i përshtatshëm që nxënësit të përkujtohen se maltretimi i tjerëve ose dhuna në shkollë nuk do të jenë të tolerueshme në asnjë rast.
- Përmbledhja dhe shqyrtimet përfundimtare janë të rëndësishme aq sa edhe përgaditja.
- Nëse është e nevojshme, mësimëdhënësi mund të ndajë çështjet e pa zgjedhura të cilat kërkojnë analizë të detajuar ose-dhe aktivitete plotësuese dhe mund të vazhdojë diskutimin haren tjetër.

A është më mirë në diskutim të perdoren rastet dhe shembujt e ekstremizmit të dhunshëm lokal apo ndonjë nga shtetet tjera?

- Është e mundshme të perdoren shembujt e ekstremizmit të dhunshëm nga librat, shtetet tjera ose nga komuniteti i vet.
- Nëse të gjithë ose disa nxënës në klasë janë të njoftuar me shembujt e ekstremizmit në mjedisin e afërt, nuk ka arsye të anashkalohen sepse nxënësit gjithsesi do të flasin për ato raste mbas diskutimit, por atëherë do diskutojnë pa udhëheqës dhe pa intervenime të nevojshme nga mësimitdhënësi. Për këtë arsye, më mirë është që këta shembuj të punohen në orë dhe të përkushtohen që të gjitha konfuzionet edhe eventualisht qendrime diskriminuuese të korigohen. Posaçërisht është e rëndësishme të parandalohet që hapja e kësaj teme të nxisë pasoja negative në viktimat e radikalizimit, familjeve të tyre për të cilat është komentuar në diskutim.
- Paraqitja e shembujve lokal në diskutime në orë mund të bëjnë atë çështje relevante për nxënësit, por mund të çojë tek rezultate shqetësuese dhe emotive. Për këtë mësimitdhënësi duhet të balancojë diskutimin ashtu që ajo mos të çojë deri tek pasojat negative për nxënësit, por edhe të kuptojnë se për ata ende është relevante.
- Nëse flitet për fenomen lokal të ekstremizmit të dhunshëm, mësimitdhënësi mund të thirret në atë fenomen në planin konceptual, duke folur për shkaqet e ndryshme dhe nxitësit e ekstremizmit, si dhe në ndikimin e tyre. Kjo do të ndihmojë nxënësit që të merren me atë temë me distancë të caktuar dhe do të kufizojë përfshirjen personale e cila mund të pengojë debaten e hapur dhe konstruktive.
- Gjithsesi nuk duhet të mbetet vetëm në shembuj nga mjedisi. Nëse është e mundshme, mësimitdhënësi duhet të theksojë shembujt të ndryshëm dhe ashtu të pengojë që nxënësit të formojnë kuptimin e ekstremizmit në mënyrë stereotipe në lidhje me një

grup apo popullatë të caktuar.

- Për arsye të njëjtë, nuk duhet të mbetet vetëm në shembujt të cilët janë të largët dhe të panjohur për nxënësit dhe të cilët mund të formojnë përshtypje të gabueshme dhe stereotipe se radikalizimi është diçka që ndodhë vetëm në disa shtete tjera të caktuara, dhe se tjerat janë immune.

A të merremi me problemin e propagandës ekstremiste në internet?

- E nevojshme është që të merremi haptas gjatë debatit për ekstremizem të dhunshëm me problemin e propagandës në internet.
- Edhe pse propaganda nuk është instrument i ri për përhapjen e ideve të dëmshme dhe ekstremiste, ajo ka ndikim më të madh sot për arsye të qasjes më të gjërë në internet. Për këtë është e nevojshme të merremi me atë problem në fazën e hershme, duke nxitur aftësitë e mendimit kritik dhe duke nxitur që nxënësit të analizojnë burimet e informacioneve dhe motivin e personave të cilët përhapin materijale me përmbajtje ekstremiste në internet.
- Për nxënësit mund të jetë posaçërisht e rëndësishme të mësojnë taktikat më të frekventuara dhe mënyrat e manipulimit në kuadrin të kësaj propagande dhe mënyrat si ti njohin regrutuesit.
- Njohjen e nxënësve me konceptin siç është „qytetaria digjitale“ dhe theksimin e rëndësisë së sjelljes së përgjegjshme jo vetëm në jetën reale por edhe në internet duhet të jenë pjesë e programit shkollorë që të përgjigjet në ekstremizmin e dhunshëm.

Mësimitdhënësi gjithashtu mund të mundohet që të gjejë material të mirë edukues në internet, i cili merret me ndalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe mund të tërheqë interesimin dhe vëmendjen e nxënësve.

Korniza juridike ndërkombëtare kundra ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit

Në kuptimin ligjorë, terrorizmi është çështje komplekse, e cila lidhë të drejten penale, të drejten ndërkombëtare humanitare dhe ligjet ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Nuk ekziston asnjë marrëveshje gjithëpërfshirëse që ka të bëjë me luftën kundra terrorizmit, por janë miratuar disa marrëveshje të cilat definojnë aspektet e ndryshme të atij krimi. Shumica e tyre janë miratuar në nivelin e Kombeve të Bashkuara, por ekzistojnë edhe regulativa rajonale, para se gjithash në nivel të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

Sot konceptet e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm shpesh perdoren bashkë, edhe pse nuk mund të themi se janë sinonime. Ekstremizmi i dhunshëm është koncept më i gjërë dhe përfshinë edhe aktet terroriste, si dhe ato të cilat nuk duhet të jenë ashtu të kualifikuara. Këshilli i sigurisë pranë Kombeve të Bashkuara ka caktuar dallimin ndërmjet këtyre dy termeve (Rezoluta 2178 nga viti 2014) duke definuar ekstremizmin e dhunshëm si diçka që kontribuon në terrorizëm ("conducive to terrorism").

Definimi i terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në dokumentet ndërkombëtare

Debati për definim unik të terrorizmit në bashkësinë ndërkombëtare zgjatë që nga fundi i viteve të tridhjeta të shekullit 20. Në nëntëdhjetat janë ripërti tentimet që të miratohet Konventa gjithëpërfshirëse kundra terrorizmit ndërkombëtarë, por ende nuk ka rezultate.

Ad hoc komiteti i Asamblesë së përgjithshme të KB ka dalë me definicion të terrorizmit, e cila ende nuk është miratuar si ligjërishit e obligueshme, por mund të shërbejë si definicion punues për atë krim.

Çdo person i cili kryen veprë penale sipas kësaj Konvente, përkatësisht nëse ai person, me çfarë do mjetesh, në mënyrë të paligjshme ose me qellim, shkakton: (a) vdekje apo lëndime të rënda trupore ndaj cilit do person; ose (b) dëmtim serioz ndaj pronës publike ose private, përfshirë dhe vendin e perdorimit publik, objektin shtetërorë apo qeveritarë, sistemin e transportit publik, infrastrukturen publike apo rrethinen; ose (c) dëmtim në pronë, vende, objekte ose sisteme nga paragrafi 1 (b) i këtij neni, çka rezulton ose do të mund të rezultojë me humbje serioze ekonomike, kur është qëllimi i sjelljes, nga natyra dhe konteksti i vet, frikësimi i popullatës, ose detyrimi i qeverisë

apo organizatave ndërkombëtare të bëjnë apo mos të bëjnë ndonjë veprim.

Nga çdo shtet anëtarë mvaret si do ta definojë terrorizmin në legjisllacion kombëtarë. Megjithatë, definimi duhet të jetë në përputhshmëri me obligimet nga e drejta ndërkombëtare në këtë sferë, por në të njëjtën kohë edhe në përputhshmëri me ligjet të cilat kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave të njeriut. E njëjta vlen edhe për definimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Ekzistonë një serë marrëveshjesh të Kombeve të Bashkuara të cilat kanë të bëjnë me luftën kundra terrorizmit:

- *Konventa për veprat penale dhe disa akte tjera të kryera në mjete fluturuese nga 1963.*
- *Konventa për luftën kundër rrëmbimit të paligjshëm të aeroplanëve nga 1970.*
- *Konventa për ndalimin e akteve të paligjshme kundra aeroplanëve civil nga 1971*
- *Konventa mbi parandalimin dhe dënimin e krimeve kundër personave të mbrojtur ndërkombëtarisht, duke përfshirë agjentët diplomatikë nga 1973.*
- *Konventa ndërkombëtare kundër marrjes së pengjeve nga 1979.*
- *Konventa për mbrojtjen fizike të materijalit bërthamor nga 1979.*
- *Konventa për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së lundrimit detarë nga 1988.*
- *Konventa mbi shënimin e eksplozivit plastik me qëllim të zbulimit nga 1991.*
- *Konventa ndërkombëtare për ndalimin e sulmeve*

terroriste me bomba nga 1997.

- *Konventa ndërkombëtare për luftën kundër finansimit të terrorizmit nga 1999.*
- *Konventa ndërkombëtare për ndalimin e akteve të terrorizmit nuklear nga 2005.*

Kombet e bashkuara dhe trupat e tyre të ndryshem, posaçërisht Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli i Sigurisë, kanë miratuar një numër dokumentash politik të rëndësishëm për luftën kundra terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ato dokumenta kanë rëndësi të madhe politike dhe shprehin pamjet e bashkësisë ndërkombëtare.

Ashtu që Këshilli i sigurisë në kuader të kapitullit VII KB Kartës, viti 2001, ka miratuar Rezoluten e KB 1373 (UN SC Resolution 1373 (2001), e cila obligon anëtarët të:

(a) Parandalojnë dhe shtypin finansimin e akteve terroriste; (b) Të kriminalizojnë sigurimin e vullnetshëm ose mbledhjen, me çfarëdo mënyre, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të fondeve nga shtetasit e tyre ose në territorin e tyre me qëllim përdorimin e tyre ose në dijeninë që ata do të përdoren për të kryer akte terroriste (c) Ngrijnë pa shtyrje fondet dhe mjetet tjera financiare ose resurset ekonomike të personave të cilët kryejnë ose tentojnë të kryejnë vepra terroriste ose marrin pjesë ose lehtësojnë kryerjen e akteve terroriste; entitetet në pronësi ose nën kontrollë direkte apo indirekte të atyre personave; dhe personave dhe subjekteve të cilët veprojnë në emer apo me instruksione të njerzëve dhe subjektëve të këtillë, përfshirë edhe mjetet të cilat janë formuar nga prona në pronësi ose nën kontroll të personave të këtillë dhe personave dhe subjekteve të lidhur; (d) Të ndalojnë shtetasit e tyre ose personat dhe entitetet në territorin e tyre të bëjnë ndonjë fond, asete financiare ose burime ekonomike ose shërbime financiare

ose shërbime të tjera të lidhura, direkt ose indirekt, në dobi të personave që kryejnë ose përpiqen të kryejnë ose lehtësojnë ose marrin pjesë në kryerjen e akteve terroriste akte, subjekte në pronësi ose të kontrolluar, drejtpërdrejt ose indirekt, nga persona të tillë dhe persona dhe subjekte që veprojnë në emër ose nën drejtimin e subjekteve të tilla.

Rezoluta 2178 (2014), ka të bëjnë me çështjen e "luftëtarëve të huaj" dhe obligojnë shtetet që *"të ndalojnë rrugëtimin e tyre nga apo përmes teritoreve të tyre, si dhe të kërkojnë nga ata të ndërmarrin masa për shtypjen e ekstremizmit të dhunshëm (përfshirë ndalimin e radikalizimit, regrutimin dhe mobilizimin e individeve në grupe terroriste dhe të bëhen luftëtar të huaj terrorist).*

Asambleja e përgjithshme e KB ka miratuar me 2006 Strategjin globale të KB kundra terrorizmit (United Nations Global Counter-Terrorism Strategy) e cila përfshinë edhe planin veprues. Strategjia parashikon kater shtylla të luftës kundra ekstremizmit të dhunshëm: kushtet në të cilat është e pershtatshme përhapja e terrorizmit; parandalimi dhe lufta kundra terrorizmit; ndërtimi i kapacitetëve shtetërore dhe forcimi i rolit të KB; respektimi i të drejtave të njeriut dhe sundimi i ligjit.

Rregullat në Evropë

Konventa evropiane për shtypjen e terrorizmit¹² të cilën Këshilli i Evropës e ka miratuar në vitin 1977, ka të bëjë, para të gjithash, me çështjen e ekstradimit të dyshuerve për terrorizem. Konventa është plotësuar me Protokoll në vitin 2003¹³.

Këshilli i Evropës ka miratua në vitin e 2005. Konventen për parandalimin e terrorizmit i cili theksin e vën në provokime, regrutime dhe ushtrime publike për akte terroriste¹⁴.

Bahskimi Evropian në vitin 2005. ka miratuar Strategjinë për luftën kundra terrorizmit. Bëhet fjalë për dokumenta politik thelbësorë i cili definon qëllimet dhe mjetet me të cilat anëtarët duhet të përgjigjen në kërcënimin nga terrorizmi. Fjalët kyçe janë parandalimi, mbrojtja, ndjekja dhe përgjigjja¹⁵.

12 European Convention on the Suppression of Terrorism <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/090>

13 <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/190>

14 <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016808c3f55>

15 <https://www.consilium.europa.eu/en/policies/fight-against-terrorism/eu-strategy/>

Respektimi i të drejtave të njeriut në luftën kundër terrorizmit

Lufta kundër terrorizmit mban dhe një serë sfidash të cilat kanë të bëjnë me vendosjen e ekuilibrit ndërmjet sigurisë së qytetarëve dhe respektimit të drejtave të njeriut.

Prej kohësh është njohur që ekziston një rrezik i vërtetë që disa qasje dhe masa për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm rrezikojnë respektimin e të drejtave të njeriut ose madje edhe kthejnë mbrapa standardet e arritura në këtë fushë. Ky fakt është forcuar posaçërisht mbas ngjarjeve tragjike të 11 shtatorit 2001. Hulumtimet vazhdimisht kallzojnë se edhe demokracitë më të zhvilluara luftojnë për balancimi e këtyre dy qellimeve të rëndësishme, përkatësisht me përputhshmërinë e kërkesave për mbrojtje të shoqërisë dhe të drejtave dhe lirive elementare.

Organizatat ndërkombëtare dhe insitucionet kanë reaguar në këtë sfidë me prurjen e disa udhëzimeve dhe instruksioneve, normave dhe teksteve referente për ndalimin e trendeve negative dhe ofrimin e setit të standardeve të drejtave dhe lirive të njeriut në luftën kundër terrorizmit. Këto udhëzime janë dizajnuar ashtu që të shërbejnë si udhëzues praktik për politikë antiteroriste, legjislacion dhe aktivitete të cilat janë efikase dhe respektojnë të drejtat e njeriut¹⁶.

16 Dokumentet në mënyrë më të detajuar mund ti gjeni në <https://www.osce.org/odihr/29103?download=true>, https://www.fidh.org/IMG/pdf/9.25_fidh_final_compressed.pdf

Thelbin e të gjitha udhëzimeve Kofi Anan e përmbledh në një apel „Siguria reale është përfundimisht në lidhje me sigurimin e një mjedisi ku të gjitha të drejtat e njeriut përmbushen, respektohen dhe mbrohen - kjo nuk do të arrihet nëse liritë themelore dëmtohen, hapësira demokratike është e mbyllur, dhe tjetërsimi dhe pakënaqësia kanalizohen në dhunë të motivuar politikisht.”¹⁷

„Teroristet askujt nuk i japin përgjegjësi. Ne, nga ana tjetër, kurrë nuk guxojmë të humbim nga pamja përgjegjësinë tonë ndaj qytetarëve të botës së gjërë. Ne luftën tonë kundër terrorizmit, ne kurrë nuk guxojmë të rrezikojmë të drejtat e njeriut. Kur ta bëjmë atë, e lehtësojmë arritjen e një qellimi terrorist. Me dorëheqjen nga superioriteti moral, ne nxisim tenziona, urrejtje dhe mosbesim në qeveri tek ato grupe qytetare në të cilët terroristët gjejnë rekrutues.”¹⁸

Dokumentet më të rëndësishme të cilët duhet të respektohen edhe gjatë luftës kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm janë Pakti ndërkombëtarë për të drejtat qytetare dhe politike dhe Konventa për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive elementare të njeriut.

17 Kofi Annan, <https://studylib.net/doc/12909862/>

18 Larger Freedom: Towards Development, Security and Human Rights for All, u https://www.unodc.org/documents/terrorism/Publications/Module_on_Human_Rights/Module_HR_and_CJ_responses_to_terrorism_ebook.pdf

Terme të rëndësishme

Fundamentalizmi

Fundamentalizmi është koncept kompleks, shumëdimensional dhe ambivalent i cili në literaturën moderne gjithnjë e më shumë lidhet me modernitetin dhe shihet si pasojë e një lloji të përplasjes së kulturës tradicionale me frymen e modernizimit, e posaçërisht me sekularizmin. Fundamentalizmi, në këtë aspekt, do të nënkuptonte reagim të ashpër në sfidat e modernizimit dhe sekularizmit.

Ekzistojnë katër kuptime apo kontekste në të cilën koncepti i fundamentalizmit lajmërohet në shkencat shoqërore moderne:

- 1) Lëvizja fetare në protestanizmin amerikan në shekullin XIX i XX;
- 2) Një term që është lidhur gjithnjë e më shumë me Islamin në çerekun e fundit të shekullit: termat alternative janë rigjallërimi, integrimi, islamizmi, etj.
- 3) Tendencat fundamentaliste në religjionet tjera botërore (judaizmi, hinduizmi, sikizmi, kisha të ndryshme të krishtera, duke përfshirë edhe katolicizmin dhe ortodoksinë);
- 4) Fundamentalizmi i cili nuk ka baza në religjion, por në politikë ose në sferat tjera të jetes (p.sh. fundamentalizmi etnik).

Fundamentalizmi karakterizon ngushtimin e fushës shpjeguese dhe pluralizmin e interpretimit, pavarësisht nëse është fjala për fenomene religjioze ose jo religjioze. Monizmi shpjegues lajmërohet si rrugë në integrim dhe ekskluzivitet. Këmbëngulja

e ngurtë dhe kokëfortë vetëm për një interpretim të vetëm të ndonjë fenomeni mund të jetë problem i qartë për shpjegim, nën disa kushte, të shëndrrohet në problem politik serioz, madje edhe problem për sigurinë.

Karakteristikat tipike të fundamentalizmit të cilat lajmërohen në literaturën moderne janë:

- 1) Kthimi në bazat, përfundimisht, asaj që ka qenë në fillim, dhe që më vonë është deformuar;
- 2) Hegemonizmi dhe ekskluziviteti në aspektin e interpretimit: fundamentalizmi i kundërshtohet shpjegimit pluralist, sepse ajo pretendon të çojë në relativizem të vlerave; në vend të sajë, fundamentalizmi këmbëngul në retorikën duale dhe filozofinë e maniheizmit (Ne-Ata, Zoti-Dreqi, Miku-Anmiku);
- 3) Kundërshtimi i sekularizmit dhe refuzimi i pamjes sekulare të botës, dhe në atë aspekt tradita e iluminizmit është sfidë e veçantë dhe armik i çdo fundamentalizmi. Fundamentalizmi, gjithashtu, jep përgjigjen e vet për sfidat moderne;
- 4) Fundamentalizmi është produkt politik, social, i krizës ekonomike dhe përgjigje në gjendje krize;
- 5) Idetë fundamentaliste janë, në aspektin ideologjik, të drejtuara kundër shkencës, edhe pse vetë fundamentalizmi, në aspektin praktik, jo rrallë përdorë përparsitë e shkencave dhe teknikave moderne.

Fundamentalizmi religjioz bazohet në respektimin rigoroz të parimëve bazë dhe themelore të mësimëve të caktuara religjioze dhe refuzimin që tradita religjioze të konsiderohet në kontekstin e vet historik dhe zhvillimor; prirje që teksti religjioz të lexohet bukvalisht (literalizmi), e jo si produkt i kohës së vet apo autorit të caktuar. Shikimi në botë në të cilën theksohen të vertetat specifike substanciale të mësimit fetar tradicional, të cilat zbatohen, me vendosmëri, në realitetin e kohës moderne.

Termi i fundamentalizmit lehtë dhe shpesh bjehet në lidhje me konceptet siç janë tradicionalizmi dhe konzervativizmi. Fjala është për koncepte të afërta, por jo edhe identike.

Tradicionalizmi

Besimi në traditë, respektimi i tradites dhe sjelljes në përputhshmëri me traditën e cila jep përgjigje për kuptimin përfundimtar dhe të vërtetën absolute.

Konzervativizmi

Kuptimi i tradites si diçka statike dhe e pandryshueshme; tradita është relik i ngrirë në kohën.

Ekstremizmi

Ekstremizmi është koncept me të cilin parqiten veprat ose ideologjitë të cilat dalin nga kuadri i cili, pragmatikisht ose moralisht, konsiderohet i pranuar në shoqëri.

Fjala është për konceptin të cilin tjerët e përdorin, me të cilin individin e caktuar apo grupin, akcionin ose ideologjin, të tjerët

e kategorizojnë si „ekstreme“. Vështirë se mund të gjindet grupi i cili vehten e quan ekstremiste. Ata më shpesh vehten do ta quajnë „radikalistë“, për çka termi radikalizem sot jo rrallë lajmërohet si lloj i eufemizmit për ekstremizem.

Në aspektin politik, flitet për ekstremet e të djathtës ekstreme, por edhe për të majtën ekstreme, si edhe për radikalizem, reacionizem, fundamentalizem dhe fanatizem.

Bëhet fjalë për bindjet fanatike se politika e vet është e vetmja e cila është e drejtë, e të tjerat janë të rrejshme. Ekstremizmi politik është përfaqësimi i ndonjë ideje politike deri tek kufijtë e fundit të saj, madje edhe me çmimin e rrezikimit të disa vlerave të rëndësishme.

Vëzhguar nga aspekti ideologjik, ekstremizmi politik është "përfaqësimi i ndonjë ideje politike deri tek kufijtë e saj të fundit, pa marrë parasysh pasojat, pazbatueshmërinë, arsyet kundra ose ndjenjen e distancimit". Ndër linjat e njohura të ekstremizmit janë: 1) manishizmi; 2) përsosmëria ontologjike e qellimit; 3) standarde të dyfishta; 4) avokimin e ditës së gjykimit; 5) substancializmi njohës; 6) frikësimi argumentues (Antoniq, 2006:23).

Do të duhej të merrej parasysh fakti se termet ekstremizem dhe radikalizem janë „arbitrarisht“ të caktuar „nga ana e fuqive dominante shoqërore në shoqëri konkrete“ (Ilić, 2013:66), dhe se ato janë relative dhe relacionale, si dhe faktin se „kultura socio-ekonomike dhe kultura e marrëdhënieve ndërmjet pakices dhe shumices“ me vendosmëri përcakton çka është e djathtë e çka është e majtë në aspektin ideologjiko-politik (Bakiq, 2007:34). Për disa ekstremizmi është „freedom fighter“ (luftar për paqe), për tjerët është „terroristë“, në varësi nga sistemi i vlerave të vëzhguesit. Gjithashtu, konteksti aktual ose historik në masë të madhe ndikon në kategorizimin e ekstremistit.

Lidhje të dobishme

- <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000244676>
- http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-best-practices/docs/ran_collection-approaches_and_practices_en.pdf
- <http://unesdoc.unesco.org/images/0023/002329/232993e.pdf>
- <http://www.unesco.org/new/en/education/themes/leading-the-internationalagenda/human-rights-education/resources/projects/teaching-respect-for-all/>
- <http://unesdoc.unesco.org/images/0021/002197/219768e.pdf>
- <http://unesdoc.unesco.org/images/0018/001841/184162e.pdf>
- http://www.unescobkk.org/fileadmin/user_upload/ict/SRU-ICT/SRU-ICT_mapping_report_2014.pdf
- http://dera.ioe.ac.uk/8396/1/DCSF-Learning%20Together_bkmk.pdf
- http://westyorkscb.proceduresonline.com/chapters/p_violent_extreme.html#risks
- <http://educateagainsthate.com/parents/what-are-the-warning-signs/>
- <http://familiesmatter.org.uk/spot-signs-radicalisation/>
- <http://www.cscb-new.co.uk/wp-content/uploads/2015/09/Radicalisation-and-extremism-guidance-for-professionals1.pdf>
- https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-best-practices/docs/ran_collection-approaches_and_practices_en.pdf
- <http://faculty.nps.edu/ambaylou/baylouny%20emotions%20poverty%20politics.PDF>
- <https://books.google.com/books?id=qZuXdUgb1gsC&printsec=frontcover&dq=pape+cutting+the+fuse&hl=en&sa=X&ei=O29rT-WIPKndOQHlzqS3Bg&ved=0CD8Q6AEwAA>

- http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PNADT977.pdf
- https://www.counterextremism.org/download_file/10/134/6/
- http://www.gsdrc.org/wp-content/uploads/2016/02/Violent-extremism_RP.pdf
- <http://www.candi.nhs.uk/about-us/corporate-information/safeguarding/radicalisation-and-extremism>
- <http://www.kcdamad.org/wp-content/uploads/2015/06/Integrisani-odgovor-zajednicena-izazove-po-ljudsku-sigurnost.pdf>
- https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/97976/prevent-strategy-review.pdf
- <http://www.osce.org/atu/111438?download=true>
- <http://www.undp.org/content/dam/undp/library/Democratic%20Governance/Conflict%20Prevention/Discussion%20Paper-Root%20Causes%20of%20Radicalization.pdf?download>
- <http://data.unhcr.org/syrianrefugees/download.php?id=10129>
- https://ec.europa.eu/home-affairs/e-library/glossary_en#terrorist-propaganda
- https://www.counterextremism.org/download_file/10/134/6/
- <http://ro.ecu.edu.au/cgi/viewcontent.cgi?article=1046&context=asi>
- https://www.nyidanmark.dk/NR/rdonlyres/E9353925-A523-41C6-94F1-643EACF826CC/0/minbiz007_actieplanukv3.pdf
- <https://www.un.org/counterterrorism/ctitf/en/plan-action-prevent-violent-extremism>
- <http://www.osce.org/secretariat/289911?download=true>
- https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network_en
- http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/Pdacs400.pdf

